

TRANSPORTI I UDHETAREVE BRENDA VENDIT

"Licence" është dokumenti, qe i njeh titullarit te saj te drejten per te kryer sherbime ne transportin rrugor, per te trete ose me qira te udhetareve brenda vendit, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi

KRITERET E LICENSIMIT

Pranimi ne veprimtarine e subjektit te transportit rrugor te udhetareve per te trete dhe me qira brenda vendit

Kriteret e pranimi perfshijne:

- a) reputacionin e mire;
- b) qendrueshmerine e duhur financiare;
- c) kompetencen profesionale;
- d) nje vendosjeje efektive dhe te qendrueshme ne Shqiperi

Aplikimi per licencim dhe dokumentet e nevojshme:

1.1 Dokumentat

- a) Vetedeklarimi per reputacionin e mire te perfaqesuesit ligjor te subjektit transportues dhe drejtuesit/drejtuesve te veprimtarise, lidhjet 7 /1 dhe 7/2.
- b) Dokumenti nga nje institucion bankar ose financiar, qe verteton gjendje te qendrueshme financiare, i cili mund te jete:
 - i) nje dokument/garanci bankare;
 - ii) nje dokument i leshuar nga shoqeri sigurimi
- c) Certifikata e kompetences profesionale per drejtuesin e veprimtarise, i cili mund te jete ortaku i vetem ose nje prej ortakeve, apo administratori i subjektit ose nje person i punesuar me kontrate per nje periudhe te pakten 5 vjecare;
- d) Regjistrimi ne Regjistrin Tregtar prane Qendres Kombetare te Biznesit (QKB), ku objekti i veprimtarise duhet te jete "Per transport udhetaresh brenda vendit".

1.2 Per mjetet, numrin e nevojshem te kerkuar per sherbimin qe do te operohet dhe per secilin mjet dokumentet si me poshte:

- a) Leja e qarkullimit;
- b) Certifikata e kontrollit teknik te mjeteve;
- c) Aktivleresimi ne plotesimin e kushteve te komoditetit te mjeteve ne transportin e udhetareve brenda vendit, leshuar nga Drejtoria e Pergjithshrne e Sherbimeve te Transportit Rrugor (DPSHTRR), sipas udhezimit nr. 1649, date 16.8.1999, "Mbi plotesimin e disa kushteve te vecanta ne transportin rrugor te udhetareve", te ndryshuar;
- d) Certifikata e kalibrimit te tahogرافit;
- e) Regjistrimi i mjeteve ne QKB.

Per me shume informacion mbeshtetuni ne Udhezimin Nr.5627, date 18.11.2016

1.3 Per drejtuesin e mjetit dokumentet, si me poshte:

Leja e drejtimit per drejtuesin e mjetit, me kategorite perkatese per mjetin qe drejton;

Certifikata e aftesise profesionale (CAP) per drejtuesit e mjeteve ne perputhje me udhezimin nr. 3606/2, date 28.10.2011, "Per pajisjen e perdoruesve te mjeteve rrugore te kategorive C, CE, D (*) dhe DE, me certifikaten e aftesimit profesional (ÇAP)", te ndryshuar, kur kerkohet.

1.4 Ne rastin e sherbimeve te rregullta sipas pikes 1, te nenit 4, te kete agjenci per sherbimin e udhetareve brenda vendit, ose kontrate me nje agjenci transporti.

1.5 Police sigurimi se pronari/ perdoruesi i mjetit te transportit ka lidhur kontraten e sigurimit, sipas ligjit nr. 10076, date 12.2.2009, "Per sigurimin e detyrueshem ne sektorin e transportit", te ndryshuar, i cili ne transportin e udhetareve perfshin:

a) Sigurimin e udhetareve nga aksidentet ne transportin publik;

b) Sigurimin e pergjegjesise se pronarit ose te perdoruesit te mjetit motorik, per demet shkaktohetuar p leve te treta nga perdorimi i ketij mjeti